

Y A H R

**YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT**

FLETËN OTIM

PËR KUVENDIN KOMUNAL TË LIPJANIT



Mars - Tetor 2010

Përmbajtja:

- Hyrje,
- KATEGORITË
- NOTIMI
- Komuna e Lipjanit
- Zgjedhjet lokale në Lipjan
- Puna e Kuvendit Komunal- Legjislativit
- PJESËMARRJA E GJINISË FEMËRORE NË KUVENDIN KOMUNAL TË LIPJANIT
- Pjesëmarrja e deputeteve në diskutime gjatë seancave:

Ekipi i Organizatës Joqeveritare Youth Association For Human Rights- YAHR:

Bekim Krasniqi – koordinator i projektit
Mimoza Osmani,
Bahti Sadiku dhe
Antigona Osmani

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan
Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
webfaqja: www.ngoyahr.page.tl & www.ngoyahr.weebly.com



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

Hyrje

Në hartimin e këtij raporti të dytë për Kuvendin e Komunës së Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2009/2012 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo tre muaj.

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'i ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave

NOTIMI

Vlerësimet e paraqitura në këtë fletënotim janë të bazuara në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare, të Kuvendit Komunal të Lipjanit të cilat reflektojnë performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

YAHR në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e deputetëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit dhe subjekteve politike në kategoritë të paraqitura në vijim:

1. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancës,
2. Ngritja e çështjeve,
3. Inicimi i çështjeve urgjente,
4. Propozim pika rendit të ditës,
5. Pyetje parlamentare,
6. Amandamentimi i legjislacionit,
7. Kërkesa për interpelancë

Komuna e Lipjanit

Si vendbanim, Lipjani njihet që nga periudha romake, por jo si vend i rëndësishëm. Qytet me rëndësi dhe kryqëzim i rëndësishëm i rrugëve ishte Ulpiana, e cila ndodhej në verilindje në largësi rreth 10 km nga Lipjani. Lipjani, në periudhën romake ishte kryesisht një vendbanim i vogël në rrugën për në Lisum. Identifikimi i Lipjanit me emrin Ulpiana më vonë është vërtetuar edhe me zbulimet e gërmadhave të vendbanimeve të antikës së vjetër dhe të periudhës bizantine në Lipjanin e sotëm.

Nga antika e vjetër emri Lypenion, Lypiana padyshim vihet deri te emri i tashëm Lipjan. Ky vendbanim shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, përrreth luginës së lumit Sitnicë, qyteti ishte i vogël deri në vitin 527, kurë ka pasur emrin Ulpiana. Nën themelet e kishës së vjetër në këtë pjesë të qytezës janë zbuluar themelet e bazilikës bizantine, ndërsa nga vet Lipjani janë të njohura disa monumente - epigrafe, prej të cilave vërtetohen të dhënat për ekzistimin e Ulpianës.

Me zhvillimin e industrisë – minierës në vendbanimin e Janjevës, u bë e njohur edhe Prishtina, që deri atëherë nuk ishte e njohur. Kështu me kalimin e kohës, Lipjani humbi rëndësinë e mëparshme dhe funksiononte si një “shesh” i thjeshtë në kuptim lokal.

Në përgjithësi deri me ndërtimin e hekurudhës nga francezët, në fund të shek. të kaluar (1873-1874), Lipjani ishte një fshat i rëndomtë, i njohur si kryqëzim i rrugëve në rajon. Në këtë hekurudhë Lipjani fitoi stacionin hekurudhor krahas të cilit u ndërtuan punëtoritë e para me karakter tregtar, depot për grumbullimin e drithërave, dhe disa dyqane zejtare, kështu që deri në fund të shek. XIX gjatë kohës së sundimit turk, kjo pjesë e re e Lipjanit fitoi pamjen e një qyteze. Definitivisht, Lipjani merr formën e qarshisë rreth vitit 1890, kurse kjo pjesë e re e quajtur “qarshia” zgjerohet nga pjesa jugore dhe veriore.

Pas luftërave ballkanike zhvillohet pjesa e Lipjanit afër stacionit hekurudhor, në pjesën lindore të të cilit ekzistonin disa shtëpi që nga viti 1890. Mirëpo, me përfundimin e Luftës I-rë Botërore është rritur numri këtyre shtëpive. Ishin shtëpi me karakter fshati. Pas luftës Lipjani zgjerohet edhe nga pjesa jugore, veriore dhe perëndimore. Ndërtimet e para individuale fillojnë në pjesën përgjatë rrugëve Prishtinë-Shtime – Ferizaj, ndërsa më vonë edhe nga jugu nga Mostina (lagje e Lipjanit). Deri në vitin 1912, në kohën e sundimit turk ka qenë në përbërje të Vilajetit të Kosovës, që është shtrirë deri në Manastir. Prej vitit 1914-1918 –(Lufta e Parë Botërore) Lipjani mbetet në pjesën e Kosovës, e cila ka qenë e sunduar nga Bullgaria.

Me funksionimin e hekurudhës Kosovë-Maqedoni-Greqi u rriten aktivitetet ekonomike, konkurrenca në treg në qendra, si Mitrovicë, Ferizaj dhe Lipjan, të cilat ndikuan në dobësimin e tregut në qendrat më të mëdha, si Prishtina, Prizreni dhe Gjakova.

Që nga kjo kohë fillon të zhvillohet Lipjani. Në 120 m nga Lipjani fillon formimi i pjesës tjetër përreth stacionit, kryesisht aktivitete tregtare. Me ndërtime individuale gjithashtu përfshihet edhe pjesa në anën e majtë dhe të djathtë të rrugës për në Prishtinë.

Në veri të vendbanimit janë ngritur objektet publike dhe bujqësore, derisa në rrugën për Magurë ngritën objektet kolektive të banimit. Në kuadër të Lipjanit hynë edhe qyteza e vjetër e vendbanimit të Janjevës, e cila përfshin pjesën qendrore nga ana veriore – malore e Komunës së Lipjanit, ndërsa nga aspekti tregtar më shumë gravitohej nga Prishtina.

Në vitin 1918 fillon ndarja në Banovina. Lipjani ka qenë njësi nën prefekturën e Prishtinës, kurse qendra e Banovinës ka qenë në Shkup. Mandej Lipjani hyri në kuadër të rrethit të Graçanicës me seli në Prishtinë, kurse si qytezë Lipjani është shpallur në vitin 1920. Nga viti 1925 bëhet një organizim i ri me këshilla lokale: Shalë, Janjevë, Gushtericë, Babush i Muhaxherëve, Magurë dhe Lepi. Lipjani ka qenë qendër e këtyre këshillave lokale, me kryetarin e këshillave lokale nën prefekturën e Prishtinës deri më 1941.

Zgjedhjet lokale në Lipjan

Kuvendi Komunal i Lipjanit ka 31 ulëse. Në mandatin e parë qeverisës, shumica e vendeve në KK i ka takuar LDK-së. Dy vite ma vonë, zgjedhjet e dyta lokale nxorën PDK-në si partinë më të madhe në këtë komunë. PDK fitoi 14 ulëse dhe së bashku me një përfaqësues të AAK qeverisën me komunën për pesë vite. Edhe në mandatin e tretë PDK kishte shumicën e ulëseve, edhe pse kishte një përfaqësues më pak. Edhe numri i votave për këtë subjekt politik kishte rënë në krahasim me zgjedhjet e vitit 2002. Humbjen më të madhe të votave në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 e pësoi LDK, votat e së cilës u përgjysmuan. Në katër legjislaturat e gjertanishme vetëm tri parti politike kanë arritur që të përfaqësohen vazhdimisht. Në zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009, prapë udhëheqë PDK-ja si parti më e madhe në komunë me 12 deputet. Kemi një rritje të LDK-së në 9 deputet si pasojë e anulimit të rezultateve në Qendrën e votimit në Shalë. Kemi një ulje të LDD-së dhe AKR-së dhe një ngjertje të AAK-së. Risi në këtë legjislaturë është hyrja e PSD-së me një deputet.

Në legjislaturën e dytë (2002-2007) kanë qenë të përfaqësuar edhe dy serbë nga dy parti të ndryshme politike. Kurse në legjislaturën e (2007-2009) edhe komuniteti ashkali kishte siguruar një vend, kurse të tanishmen (2009-2013) nuk asnjë deputet nga komunitetet pakicë.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007		Zgjedhjet 2009	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	8317	13	10283	14	8925	13	7,926	12
LDK	10718	16	9923	13	4404	7	6,474	9

AAK	1109	2	840	1	929	1	1,036	2
LDD	-	-	-	-	1677	3	1,138	2
AKR	-	-	-	-	3007	5	2,652	4
ORA	-	-	-	-	746	1	477	1
PDAK	-	-	-	-	563	1	-	-
DCC	-	-	523	1	-	-	-	-
"Povratak"	-	-	391	1	-	-	-	-
PSD	-	-	-	-	-	-	847	1

Puna e Kuvendit Komunal- Legjislativit

Organizata Joqeveritare YAHR, e kemi përcjellur punën e legjislativit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit në pesë seanca të mbajtura deri më tani. Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletënotimit kemi konstatuar këto fakte:

FAKTE:

- Kuvendi i Lipjanit ka bërë shkelje të statutit të komunës në mbledhjen e dytë të mbajtur në fund të muajit shkurt 2010 . Me rastin e miratimit të emërimeve të drejtoreve të propozuara nga ana kryetarit Z. Shukri Buja. Ku është shkelur neni 47 i statutit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit të miratuar me datën 26.09.2008, ku parashihi të jenë 10 drejtori ,ndërsa janë emëruar 13 drejtorë në 13 drejtori. Por, ka pasur përpjekje nga ana e legjislativit për harmonizimin e statutit me gjendjen faktike në seancën e gjashtë të datës: 08.07.2010. Por kjo përpjekje ka dështuar në mungesë 2/3 e votave të delegatëve të Kuvendit Komunal.
- Po ashtu në këtë mbledhje është shkelur ligji për vetëqeverisje lokale i republikës së Kosovës i datës: 20 shkurt 2008 nr. 03/L-040 neni 61 dhe nenin 44 i statutit komunal. Në rastin e zgjedhjes së nënkryetarit të dytë i cili është i paraparë të jetë nga komunitetet pakicë . Në këtë rast nënkryetari i dytë është zgjedhur nga komuniteti shumicë.
- Në mbledhjen e katërt të Kuvendit Komunal të Lipjanit të datës 29 prill 2010. Është bërë shkelje e statutit të komunës nenin 64.1 dhe 64.2 dhe nenit 6 të rregullores për transparencë të miratuar nga Kuvendi Komunal me datën 20.03.2009. Ku Kuvendi Komunal i Lipjanit pa konsultim me publikun miraton rregulloren për transportin e udhëtareve me automjetet taksit.
- Po ashtu kemi konstatuar mos efikasitet të punëve të Komiteteve të formuara, e sidomos Komitetit i përkohshëm i cili është formuar në mbledhjen e mbajtur me datën: 31 marsit 2010 për organizimin e zgjedhjeve të këshillave të fshatrave, që deri më tani ka mbajtur Katër mbledhje. Por, nuk kemi asnjë lëvizje konkrete edhe pse është premtuar nga kryetari Z. Shukri Buja se procesi i zgjedhjeve të këshillave të fshatrave do të mbahet gjatë muajve Maj/Qershor 2010 që është thënë në debatin me qytetarët të

mbajtur me datën: 18.03.2010. Pastaj ka pasur përpjekje tjetër dhe është marrë vendim në takimin që ka pasur Kryetari i Komunës Z. Shukri Buja ,Kryesuesi i Kuvendit Lulzim Rrustemi dhe anëtarët e komitetit të përkohshëm për këto çështje me datën: 24.08.2010 dhe është caktuar edhe një periudhë tjetër e mbajtjes dhe organizimit të këtyre zgjedhjeve nga 15 Shator-15 Nëntori 2010 edhe kjo përpjekje ka dështuar.

- Në seancën e pestë të datës: 26.05.2010. Kuvendit Komunal është marrë vendimi për lejin e ndërtimi një depoje për vendosjen dhe ruajtjen e eksplozivëve komercial dhe mjeteve piroteknike në ZK Babush i Muhaxherve, pa u konsultuar dhe informuar me banorët e këtij vendbanimi.
- Në seancën e gjashtë të datës **08.06.2010** të ashtuquajtur “Urgjente” ,deputete e Kuvendit i marrin thirrjet dhe materialet për seancë vetëm një ditë dhe disa deputet prej tyre edhe disa orë para se të fillojë seanca e Kuvendit komunal të Lipjanit, duke veçuar mbi rendësin e kësaj seance e cila kishte të bëjë me rishikimin e buxhetit për vitin 2010. Që është shkelur rregullorja Nr. 110-623 të datës 26.09.2008 e punës së Kuvendit Komunal .
- Organizata jonë gjatë monitorimit të aktiviteteve të deputeteve në seancat e Kuvendit komunal ka konstatuar se mungon një efikasitet e pjesës së opozitës për artikulimin e interesave të qytetarëve. Dhe është për tu çuditur se si miratohet buxheti komunal për vitin 2011 me 13.09.2010 ku me 31 vota të deputete dhe me asnjë votë kundër e aprovojnë projekt buxhetin.

Tabela e numrit të vendimeve dhe rregulloreve të Kuvendit Komunal në Lipjan				
Mbledhjet e Kuvendit Komunal	Vendimit për dhënie në shfrytëzim të tokës	Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm	Vendime të tjera	Rregulloret të ndryshme komunale
Seanca III	1	1	2	-
Seanca IV	1	1	-	1
Seanca V	2	-	2	-
Seanca VI	-	-	1	-
Seanca VII	-	-	1	2
Gjithsej	4	2	6	3

REKOMANDIME:

- Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhet së shpejti të bëjë ndryshime në statutin komunal të nenin 47, për tu përshtatur me realitetin e krijuar.

- Një opozitë me e zorshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit.
- Kuvendi i Komunës së Lipjanit në të ardhmen para se të miratojë rregulloret duhet respektuar statutin komunal, gjegjësisht nenin 64.1 dhe 64.2 dhe nenit 6. të rregullores për transparencë, pra duhet të organizojë debate me qytetarët.
- Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.
- Kuvendi Komunal duhet paraprakisht ta informojë dhe të konsultohet me qytetarët në rast të marrjes së vendimeve që e prekin interesin e qytetarëve drejtpërdrejtë në pjesë të caktuara.

Deputetet e Kuvendit Komunal në Lipjan 2009/2013

Nr	Deputetët	Subjekti politik	e-mail	Telefoni
1	FITIM SELIMI	PDK	fitim_selimi@hotmail.com	044 224 946
2	ENVER KOZHANI	PDK	enverkozhani@hotmail.com	044 251 074
3	LULZIM RRUSTEMI	PDK		
4	BLERIM LIMANI	PDK	blerim-lim@hotmail.com	044 653 032
5	HESET SAHITI	PDK	heset_sahiti@hotmail.com	044 206 831
6	BAHTIR BAHTIRI	PDK	bahtir.bahtiri@hotmail.com	044 263 102
7	IDRIZ KRASNIQI	PDK	ikrasniqi@live.com	044 613 391
8	ILIR TASHOLLI	PDK	ilirtasholli@hotmail.com	044 256 522
9	HAJRIE SALIHU	PDK	-	044 271 588
10	AJSHE OLLURI	PDK	ajshe-olluri@hotmail.com	044 847 263
11	MAKFIRE ILAZI	PDK	makfire-ilazi@hotmail.com	044 821 315
12	SEBAHATE QERIQI	PDK	sebahate.qeriqi@hotmail.com	044 367 868
13	SEFER TASHOLLI	LDK	sefer_56@hotmail.com	044130 709
14	NASER SOPJANI	LDK	argoniti@hotmail.com	044 502 560
15	MUHAMET SHABANI	LDK	-	044 249 002
16	RAMADAN GRAIQEVCI	LDK	-	044 318 590
17	RAGIP MEHMETI	LDK	-	044 752 280
18	FAIK LEKAJ	LDK	faiki-4@hotmail.com	044 692 079
19	VLORA LIMANI	LDK	lora_limani@hotmail.com	044 470 575
20	MEVLIDE DULAHU	LDK	lida52@hotmail.com	044 201 756
21	BURBUQE FAZLIU	LDK	kaqurrelja_bucja@hotmail.com	044 876 243
22	BANUSH BYTYQI/ALBAN ASLLANI	AKR	albanasllani2009@hotmail.com	044 689 939
23	BLERIM GASHI	AKR	bgashi72@hotmail.com	044 271 534
24	ALBULENA GASHI	AKR	albulenagashi@hotmail.com	044 323 716
25	LUMTURIJE BYTYQI	AKR	happiness.al@hotmail.com	044 107 434
26	SYLEJMON REÇICA	AAK	sylejman_regica@hotmail.com	044 201 694
27	JALLDYZE GASHI	AAK	diellche@hotmail.com	045 204 539
28	HALIT GASHI	LDD	-	044 206 566
29	MEVLIDE SHAMOLLI	LDD	mevlideshamolli@hotmail.com	044 185 765
30	ZYFER ALIU	ORA	zyferaliu@hotmail.com	044 201 548

31	RIZAH QERIQI	PSD	zyrapsd@gmail.com	044 152 137
----	--------------	-----	-------------------	-------------

Lista e komiteve në kuadër të Kuvendit Komunal në Lipjan

Komiteti për Politikë dhe Financa			Komiteti për Komunitete		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik /komuniteti
1	Lulzim Rrustemi	PDK	1	Lumturije Bytyqi	AKR
2	Fitim Selimi	PDK	2	Tefik Krasniqi	PDK
3	Heset Sahiti	PDK	3	Ragip Mehmeti	LDK
4	Enver Kozhani	PDK	4	Zoran Spasiq	serb
5	Sefer Tasholli	LDK	5	Ismajl Gradina	romë
6	Naser Sopjani	LDK	6	Liman Ramadani	ashkali
7	Muhamet Shabani	LDK	7	Adil Gashi	turk
8	Blerim Gashi	AKR	8	Silvana Paliq	kroatë
9	Mevlide Shamolli	LDD	9	Zoran Çirkoviç	malazezë
10	Sylejmon Reçica	AAK			
11	Rizah Qeriqi	PSD			
Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm			Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1	Ilir Tasholli	PDK	1	Alban Asllani	AKR
2	Bahtir Bahtiri	PDK	2	Sebahate Qiriri	PDK
3	Fadil Sylejmani	LDK	3	Ismajl Gashi	PDK
4	Imer Selmani	LDD	4	Faik Lekaj	LDK
5	Afrim Bahtiri	AAK	5	Isak Gashi	LDK
Komiteti për Shëndetësi			Komiteti për Arsimit		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1	Mevlide Dulahu	LDK	1	Hajrije Salihu	PDK
2	Banush Gashi	PDK	2	Arian Hasani	PDK
3	Ajvaz Karpuzi	PDK	3	Zetëhane Sefedini	LDK
4	Afrim Pacolli	AKR	4	Hanëmshahe Osmani	LDK
5	Naser Bytyqi	PSD	5	Basri Hashani	AKR

Deputetët e Kuvendit Komunal në Lipjan 2009/2013

			
PDK - Lulzim Rrustemi	PDK - Fitim Selimi	PDK - Heset Sahiti	PDK - Enver Kozhani

 PDK - Hajrie Salihu	 PDK - Bahtir Bahtiri	 PDK - Idriz Krasniqi	 PDK - Makfire Ilazi
 PDK - Ilir Tasholli	 PDK - Blerim Limani	 PDK-Ajshe Olluri	 PDK - Sebahate Qeriqi
 LDK - Sefer Tasholli	 LDK- Muhamet Shabani	 LDK- Ramadan Grajgevc	 LDK- Ragip Mehmeti
 LDK-Mevlyde Dulahu	 LDK- Faik Lekaj	 LDK- Bërbuqe Fazliu	 LDK- Vlora Limani
 AKR - Lumturije Bytyqi	 AKR - Alban Asllani	 AKR- Blerim Gashi	 AKR- Albulena Gashi
 PSDK- Rizah Qiriqi	 I pavarur- Zyfer Aliu	 AAK-Sylejman Reçica	 AAK - Jalldyze Gashi

PJESËMARRJA E GJINISË FEMËRORE NË KUVENDIN KOMUNAL TË LIPJANIT

FAKTE:

Në bazë të statistikave dhe krahasimeve të bëra nga legjislativi i vitit 2007. ku kishim 10 deputete ose 32.25% në Kuvendin Komunal. Në zgjedhjet e vitit 2009 kemi një ngritje të përfaqësuesve të gjinisë femërore nga 10 deputete në 11 deputete ose 35.48% nga numri total i deputetëve 31. Por, prapë sikurse në zgjedhjet e vitit 2007 edhe në zgjedhjet e vitit 2009, nuk kanë arritur asnjë përfaqësuese e gjinisë femërore të zgjidhet për deputete pa kuotën e paraparë me ligj.

Në Këtë legjislative të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit të dalur nga zgjedhjet e vitit 2009, në pesë seanca të mbajtura deri më tani . Nga 11 deputete të gjinisë femërore sa i ka Kuvendi Komunal i Komunës së Lipjanit kanë qenë aktivë vetëm tri deputete ose 27%.

Deputete aktive janë: **MEVLIDE SHAMOLLI** nga partia politike LDD , **HAJRIE SALIHU** nga partia politike PDK-ë, **MEVLIDE DULAHU** nga partia politike LDK-ë, **VLORA LIMANI** nga partia politike LDK-ë, dhe **LUMTURIJE BYTYQI** nga partia politike AKR-ë.

Deputetet pasive janë:, **AJSHE OLLURI** . **JALLDYZE GASHI**, **Sebahate Qeriqi** ,. **Burbuqe Fazliu** , **ALBULENA GASHI** dhe **Makfire Ilazi**

REKOMANDIME:

Duhet një angazhim më i plotë i deputeteve në seanca plenare, që të dëshmohet se janë zgjedhur për të përfaqësuar interesin e qytetarëve, e jo vetëm për ti plotësuar vendet të cilat janë të garantuar me ligj.

PJESËMARRJA E GJINISË FEMËRORE NË KUVENDIN KOMUNAL NË LIPJAN											
Nr.ulseve në asamble		Nr.femrave në asamble				Nr.deputeteve (femra) të zgjedhura pa kouten e paraparë me ligjë		Nr. Deputeteve të rizgjedhur			
2009	2007	2009	%	2007	%	2009	2007	2009	2007		
31	31	11	35.48	10	32.25	0	0	10	9	5	6

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime në bazë të fletënotimit për se cilin deputet:

Nr	Deputetët	Subjekti politik	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancës	Ngritja e çështjeve	Inicimi i çështjeve urgjente	Propozim ika rendit të ditës	Pyetje parlamentare	Amandamentimi i legjislacionit	Kërkesa për interpelancë
1	FITIM SELIMI	PDK	12	1	0	0	0	0	0

2	ENVER KOZHANI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
3	LULZIM RRUSTEMI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
4	BLERIM LIMANI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
5	HESET SAHITI	PDK	8	0	0	0	0	0	0
6	BAHTIR BAHTIRI	PDK	2	0	0	0	0	0	0
7	IDRIZ KRASNIQI	PDK	3	0	0	0	0	0	0
8	ILIR TASHOLLI	PDK	1	0	0	0	0	0	0
9	HAJRIE SALIHU	PDK	1	0	0	0	0	0	0
10	AJSHE OLLURI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
11	Makfire Ilazi	PDK	0	0	0	0	0	0	0
12	Sebahate Qeriqi	PDK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP PDK-se			27	1	0	0	0	0	0
13	SEFER TASHOLLI	LDK	28	2	0	0	3	0	0
14	NASER SOPJANI	LDK	1	0	0	0	0	0	0
15	MUHAMET SHABANI	LDK	7	1	0	1	2	0	0
16	RAMADAN GRAIQEVC	LDK	0	0	0	0	0	0	0
17	RAGIP MEHMETI	LDK	2	0	0	0	0	0	0
18	FAIK LEKAJ	LDK	0	0	0	0	0	0	0
19	VLORA LIMANI	LDK	4	0	0	0	0	0	0
20	MEVLIDE DULAHU	LDK	9	1	0	0	0	0	0
21	Burbuqe Fazliu	LDK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP LDK-se			51	4	0	1	5	0	0
22	ALBAN ASLLANI	AKR	4	0	0	0	0	0	0
23	BLERIM GASHI	AKR	17	1	0	0	1	0	0
24	ALBULENA GASHI	AKR	0	0	0	0	0	0	0
25	LUMTURIJE BYTYQI	AKR	2	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP AKR-se			23	1	0	0	1	0	0
26	SYLEJMON REÇICA	AAK	19	2	0	0	1	0	0
27	JALDYZE GASHI	AAK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP AAK-se			19	2	0	0	1	0	0
28	HALIT GASHI	LDD	6	0	0	0	0	0	0
29	MEVLIDE SHAMOLLI	LDD	15	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP LLD-se			21	0	0	0	0	0	0
30	ZYFER ALIU	ORA	4	0	0	0	0	0	0
31	RIZAH QERIQI	PSD	11	0	0	0	0	0	0
TOTALI			156	8	0	1	7	0	0

Pjesëmarrja e deputeteve në diskutime gjatë seancave:

FAKTE:

Kemi konstatuar një pasivitet të theksuar të deputeteve. Ku nga 31 deputet sa i ka Kuvendi komunal i Komunës së Lipjanit. Në 8 seancat të mbajtura deri më tani kanë qenë aktivë vetëm 20 deputet ose 66.66 % , pesë më shumë krahasuar me periudhën mars –qershor 2010 ku kishim 15 deputet ose 48.38%. Ndërsa nuk kanë qenë aktivë, por në cilësinë e “Shikuesve” janë vetëm 10 ose 33.33 % apo 5 më pak krahasim me periudhën mars –qershor 2010 ku kishim 15 deputet ose 51.62% . Kjo do të thotë se bërja publike e aktiviteteve të deputeteve nga

organizata jonë ka pasur ndikim në rritjen e pjesëmarrjes së deputeteve në diskutime në Kuvend.

Deputetet më aktivë kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: **SEFER TASHOLLI ,FITIM SELIMI, SYLEJMON REÇICA, MEVLIDE SHAMOLLI ,BLERIM GASHI ,HESET SAHITI ,HALIT GASHI ,RIZAH QERIQI ,MEVLIDE DULAHU ,ZYFER ALIU ,MUHAMET SHABANI ,ALBAN ASLLANI ,IDRIZ KRASNIQI , NASER SOPJANI, HAJRIE SALIHU, ILIR TASHOLLI , RAGIP MEHMETI , BAHTIR BAHTIRI dhe LUMTURIJE BYTYQI**

Deputete më pasivë të ashtuquajtur “Shikues” janë: **ENVER KOZHANI ,BLERIM LIMANI, , AJSHE OLLURI ,Makfire Ilazi , JALLDYZE GASHI, Sebahate Qeriqi , RAMADAN GRAIQEVCI , FAIK LEKAJ , VLORA LIMANI , ALBULENA GASHI dhe Burbuqe Fazliu.**

REKOMANDIME:

Një angazhim më efikas i deputeteve në mbrojtje dhe në artikullimin e interesave të qytetareve të komunës së Lipjanit.



Deputet aktivë, me numrin e diskutimeve				Deputetet pasivë, me asnjë diskutim			
1	SEFER TASHOLLI	LDK	28	1	ENVER KOZHANI	PDK	0
2	SYLEJMON REÇICA	AAK	19	2	BLERIM LIMANI	PDK	0
3	BLERIM GASHI	AKR	17	3	AJSHE OLLURI	PDK	0
4	MEVLIDE SHAMOLLI	LDD	15	4	Makfire Ilazi	PDK	0
5	FITIM SELIMI	PDK	12	5	Sebahate Qeriqi	PDK	0
6	RIZAH QERIQI	PSD	11	6	RAMADAN GRAIQEVCI	LDK	0
7	MEVLIDE DULAHU	LDK	9	7	FAIK LEKAJ	LDK	0
8	HESET SAHITI	PDK	8	8	Burbuqe Fazliu	LDK	0
9	MUHAMET SHABANI	LDK	7	9	ALBULENA GASHI	AKR	0
10	HALIT GASHI	LDD	6	10	JALLDYZE GASHI	AAK	0
11	VLORA LIMANI	LDK	4				
12	ALBAN ASLLANI	AKR	4				
13	ZYFER ALIU	ORA	4				
14	IDRIZ KRASNIQI	PDK	3				
15	BAHTIR BAHTIRI	PDK	2				
16	RAGIP MEHMETI	LDK	2				
17	LUMTURIJE BYTYQI	AKR	2				
18	ILIR TASHOLLI	PDK	1				
19	HAJRIE SALIHU	PDK	1				
20	NASER SOPJANI	LDK	1				

FAKTE:

Gjatë tetë seanca sa janë mbajtur deri më tani në Kuvendin Komunal. Nuk kemi pasur asnjë Inicimi I çështjeve urgjente dhe Kërkesa për interpelancë të ekzekutivit nga deputetet e Kuvendit Komunal në Lipjan.

REKOMANDIME:

Një angazhim më efikas i deputeteve në mbrojtje dhe në artikulimin e interesave të qytetareve të komunës së Lipjanit.

Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancës**Ngritja e çështjeve**

Pyetje parlamentare

